



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-13265 dt. 14 / 04 / 2026

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Drenasit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

th ë r r e t

mbledhjen e **tretë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më datë: **21.04.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e bordit të drejtorive, (kati tretë) i Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes se Komitetit për Politike dhe Financa i datës: 18.03.2026.
2. Propozim vendim për miratimin e Planit Lokal të veprimit në mjedis 2026-2030.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit/Glllogocit 2026-2028.
4. Propozim vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë.
5. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.
6. Të ndryshme

Drenas, 14.04.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 062/01-13262 dt. 14/04/2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.03.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi, kryesues i Kuvendit, Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Selman Çallapeku (PDKRLL), Pajtime Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK), Egzona Tërdevci (VV) dhe Arbër Halilaj (BD).

Të pranishëm ishin edhe: Ramiz Lladrovci (Kryetar i Komunës), Arben Shala (nënkryetar), Nexhmedin Gruda (drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike) dhe Laureta Thaqi (drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit.

REND I DITËS:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i dt. 18.02.2026;
2. Propozim-rregullore për menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore;
3. Propozim-vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL “EKO-Drenasi” Sha.A.Gllogoc;
4. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare për vitin 2024;
5. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike;

6. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajjtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70310053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m², kapaciteti 9.99 MW, vlera investive 5.800.000,00 €;
7. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajjtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 92000 m², kapaciteti 5.70 MW vlera investive 3.300.000,00 €;
8. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajjtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m², kapaciteti 9.99 MW vlera investive 5.800.000,00 €;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi Burim Bujupi, pasi përshëndeti të pranishmit, hapi diskutimin për renditn e ditës.

Egzona Tërdevci tha se, sa u përket tri pronave për TDI-në, kemi vetëm propozim-vendimet dhe nuk kemi ndonjë material tjetër. A kishim mundur të ikemi planet e biznesit, do të duhej të na përcillehin. Unë i kam ato të vitit 2024, por nuk e di a ka ndryshuar diçka.

Kryetari Ramiz Lladrovci tha se, janë pothuajse të njëjtat, çfarëdo materiali që kemi tani, i bëjmë kopje dhe ua sjellim.

Arbër Halilaj tha se, edhe unë për pikat 6, 7 dhe 8, kisha kërkuar që të mos kemi vetëm këtë arsytim. Meqë është protokolluar një projekt, mundësisht para seancës ta kemi për ta parë, edhe për shkak të transparencës, edhe për të parë përfitimet e Komunës, sa veta punësohen dhe detajet e tjera.

Kryetari Ramiz Lladrovci tregoj se, këtë vendim na e ka kthyer Ministria, për shkak së nuk kemi pasur të drejtë të bëjmë negociim pasi ka qenë në listën paraprake. Ne e kemi hequr prej listës paraprake, pastaj afati gjashtëmujor i të qenit kryetar komune na ka penalizuar për të proceduar. Ne e kemi proceduar tani në komision prej Kuvendit, ka qenë që vetë e kanë negociuar. Unë nuk kam negociuar asgjë, vetëm procesverbal kam mbajtur, ashtu siç më detyron ligji, asgjë tjetër.

Kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim këtë rend dite. Ky rend dite rekomandohet për Kuvend. **Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e parë: **1.**Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 18.02.2026. Pika e parë e rendit të ditës, kalon me përmirësimin e gabimit teknik, ndryshimin e emërimit nga "GREEN" në "BD" kërkuar nga Arbër Halilaj. **Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e dytë: **2.**Propozim-rregullore për menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore.

Arbër Halilaj tha se, kjo është një rregullore e rëndësishme që merret me menaxhimin e dokumenteve zyrtare dhe arkivore. Kjo është nën kompetencat e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, mirëpo është interesante që nuk shoh asgjëkundi të përmendet digjitalizimi

i lëndëve arkivore, nuk ka asnjë nen që flet për këtë. Është nevojë e kohës që arkivat të merren me digjitalizimin e lëndëve për një ruajtje më të mirë dhe çasje më të lehtë në dokumente. Duhet të merret parasysh futja e ndonjë neni që e rregullon çështjen e digjitalizimit.

Drejtoresha Laureta Thaqi tha se, pas një takimi me drejtorin e Agjencisë së Arkivave, ata kanë kërkuar fillimisht të rregullohet infrastruktura ligjore, sepse ne nuk kemi pasur një të tillë. Para se t'i bëjmë arkivat si komunë, i paraprin ky hap, hartimi i rregullores si dhe formimi i listës së dokumenteve me afate të ruajtjes.

Kjo e fundit nuk shkon në Kuvend, këtë e kemi hartuar dhe e kemi dërguar direkt në Agjenci, prej nga pritet të na japin pëlqimin, ndërsa rregulloren e kemi sjellë tek ju. Kjo rregullore e përcakton mënyrën si do të ruhen dokumentet dhe krijimin e një sistemi të standardizuar për ta bërë më të lehtë gjurmimin e çdo dokumenti. Në faqen 3 është i paraparë digjitalizimi, kjo rregullore mbështetet në Ligjin për Arkivat. Pasi të hartohet kjo rregullore, ne do të bëjmë klasifikimin e të gjithë dokumentacionit në bazë të listës me afate të ruajtjes.

Kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend. **Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tretë: **3.** Propozim-vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL “EKO-Drenasi” Sh.A. Gllgoc.

Egzona Tërdevci tha se, a kemi ndonjë kufizim të numrit të anëtarëve, nëse zgjidhet një nga ekzekutivi, një nga PDKRLL dhe një nga PDK, grupet e tjera po mbeten pa përfaqësim. Nëse lejohet t'i bëjmë 5 anëtarë duke i shtuar edhe dy përfaqësues të tjerë.

Arbër Halilaj, jo vetëm në këtë komision, por në përgjithësi, kisha kërkuar që të mos shkojmë vetëm sipas fuqisë së votës, sepse ka raste kur kemi ndonjë asamblist që është më ekspert i fushës dhe mund të jetë pjesë e këtij komisioni.

Kryesuesi Burim Bujupi, edhe unë jam i mendimit që ata asamblistë që zgjidhen anëtarë të komisionit, të jenë të fushave të caktuara dhe të përkushtuar në detyrat dhe përgjegjësitë që marrin, e jo ta neglizhojnë punën. Ndërsa, sa i përket rritjes së numrit të anëtarëve në 5 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL “EKO-Drenasi” Sh.A. Gllgoc, nuk e di, po na sqaron Kryetari.

Kryetari Ramiz Lladrovci tha se, e shikojmë, pyesim në Ministri dhe nëse e lejon ligji nuk ka asnjë problem, e bëjmë edhe me 5 anëtarë, nuk ka asgjë të keqe.

Kryesuesi Burim Bujupi theksoj se, edhe pika e tretë e rendit të ditës rekomandohet për Kuvend. **Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt: **4.**Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare për vitin 2024.

Egzona Tërdevci tha se, unë i kam dy çështje. Tek çështja B2, mungesa e projekteve ekzekutive, sipas sqarimit që keni dhënë, ende ka projekte-punë që po vazhdojnë pa projekte

ekzekutuese. Pse po ndodh kjo, gjithashtu, tek A5, "raportimi i rregullt për pronat komunale", e keni vendosur si të zbatuar, por nuk ka pasur raportim çdo gjashtë muaj për pronat komunale.

Kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e katërt që të rekomandohet për Kuvend. **Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë: **5. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negocimit apo shpalljes publike.**

Kryetari Ramiz Lladrovci thase, ju mund ta formoni komisionin prej të gjitha subjekteve, nga një anëtar si të vendosni ju. Siç ju thashë edhe atë ditë në seancë, këtë komision nuk kemi nevojë ta dërgojmë për ligjshmëri sepse janë vendime që i marrim brënda. Këtu vendosim se a duam zhvillimin e Komunës së Drenasit apo jo.

Arbër Halilaj, meqenëse e kemi kaluar listën paraprake në seancën e kaluar, konsideroj që ky komision reflekton transparencë. Kjo i kontribuon faktit që kushdo që dëshiron të jetë pjesë e komisionit, të jetë aty dhe t'i shprehë ato pakënaqësi, e jo për protagonizëm apo konsum publik. Këtu është vendi ku shqyrtohen pronat nga lista të cilat janë me interes të publikohen në shpallje publike, si dhe se si do të vazhdojë procedura. Pra, ky komision është komision rekomandues, kurse komisioni zyrtar është vlerësues, kështu që asnjëri komision nuk e pengon punën e tjetrit, por ndoshta vetëm e plotëson atë.

I kisha propozuar Kryetarit, para se të vijmë të pika e emrave të komisionit dhe listës së pronave. Në legjislaturën e kaluar kemi pasur diku 28 projekte që kanë mbetur në pritje për shkak të fundit të vitit dhe afatet janë tejkaluar, gjithashtu edhe për shkak të politizimit të tepërt pa nevojë. Të kontaktohen ato kompani investitore, në qoftë se kanë prapë interes të investojnë. Për t'i ndalur këto debatet publike dhe politizimin e kësaj çështjeje, meqenëse ka kaluar lista e pronave të veçanta, të dalë komplet në shpallje publike, sepse nuk e dimë për cilën pronë çfarë interesimi do të ketë, kjo i kontribuon edhe transparencës. Sa i përket komisionit dhe përbërjes, diskutojmë në seancë.

Egzona Tërdevci, unë i kam dy çështje. Së pari, nëse nuk është kthyer ende ligjshmëria, pse duhet ta bëjmë ne komisionin. Parimisht nuk e dimë a është i ligjshëm apo jo ky vendim. Së dyti, këtu thuhet të themelohet komisioni për shqyrtim të listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, ndërsa vendimin që kemi marrë ne si Kuvend Komunal është vetëm për afatgjatë. Këto dy gjëra nuk po i kuptoj.

Kryetari Ramiz Lladrovci tha se, unë e kam bërë një propozim-vendim për të bërë një komision i cili do t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat për katër vjet. A e kthen pozitiv apo negativ Ministria nuk ka rëndësi, sepse ne komisionin e formojmë. Pastaj komisioni mblidhet dhe na sjell prona të ndryshme për t'i shqyrtuar. Në këtë drejtim i njëjti komision do të jetë edhe për pronat me negocim, sepse janë me dhjetëra kërkesa në zonën e Goleshit nga disa investitorë të mëdhenj. Ju rekomandoni, unë marr vendime mbi bazën e rekomandimeve tuaja.

Arigon Sinani tha se, unë pajtohem me parafolësit, Egzonën dhe Arbërin por kisha kërkuar që nga procedura e dhënies në shfrytëzim të hiqen ato me negociim dhe të bëhet vetëm me shpallje publike, sepse nuk e shoh se është transparente përmes negociimit.

Kryetari Ramiz Lladrovci, unë e thashë që komisioni e bën negociimin për pronat me negociim dhe për ato përmes shpalljes publike, ai komision do të jetë për të dyja. Ne do t'i ndjekim të gjitha procedurat ashtu siç e kërkon ligji.

Arigon Sinani, unë mendoj që më transparente është përmes shpalljes publike, sepse me negociim gjithmonë "dallaveret" janë në tavolinë, unë ashtu mendoj.

Kryetari Ramiz Lladrovci, ky është mendim individual i paragjykuar. Kush di ta lexojë ligjin, ai e përcakton. Unë po them që negociimin e bën një komision nga të gjitha subjektet pjesëmarrëse në Kuvend dhe ma sjellin mua. Unë vetëm një procesverbal duhet të bëj, asgjë tjetër, sepse e kam obligim ligjor. Kjo është transparenca që garanton se nuk do të ketë parregullsi.

Kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e pestë: **5. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e listës së veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale dhe ofrimin e rekomandimeve të veta për pronat ndaj të cilave mund të iniciohen procedurat e dhënies në shfrytëzim përmes negociimit apo shpalljes publike. Pika rekomandohet për Kuvend.**

Për votuan 6, abstenime 1, kundër 0.

Kryesuesi Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e gjashtë: **6. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për parcelën P-70310053-00539-0 në Negroc, me sipërfaqe 109,084 m², kapacitet 9.99 MW dhe vlerë investive 5,800,000.00 €.**

Egzona Tërdevci, në parim nuk kam asgjë kundër dhënies së pronave për energji të ripërtëritshme, por kam një shqetësim. Ne i kemi dhënë TDI-së një pronë në tetor të vitit 2023, a kemi ndonjë evidencë se a ka punuar diçka, A është investitor serioz dhe a është duke i kryer punët sipas asaj që ka prezantuar kur e ka marrë pronën. Nëse nuk janë plotësuar këto kritere, nuk e di sa është e arsyeshme t'i jepen edhe tri prona të tjera dikujt që nuk ka arritur ta përfundojë punën e parë.

Kryetari Ramiz Lladrovci tha se, deri të fillimi i zbatimit të projektit, procedurat zgjasin të paktën tri vjet. Ti e di këtë dhe e ke të lehtë të pyesësh në ZRRE, procedurat të ne janë të përshpejtuara, kurse atje janë të ngadalësuara.

Kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës, e cila rekomandohet për Kuvend. **Për votuan 4, abstenime 1, kundër 2.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e shtatë: **7.** Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00913-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 92,000 m², kapacitet 5.70 MW dhe vlerë investive 3,300,000.00 €.

Kryetari Ramiz Lladrovci, Egzonë, nuk besoj që ka asnjë ndryshim, edhe nëse ka, është e paraqitur dhe arsyetimet t'i japim. Besoj se Arbeni ka folur me ta. Unë e di që janë prona që i kemi kaluar dhe i kemi sjellë prapë për ta përfunduar si proces.

Kryesuesi Burim Bujupi, pasi nuk pati diskutime, e hodhi në votim pikën e shtatë, e cila u rekomandua për Kuvend. **Për votuan 4, abstenime 1, kundër 2.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tetë: **8.** Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet të pronës së paluajtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0 në Krajkovë, me sipërfaqe 130,000 m², kapacitet 9.99 MW dhe vlerë investive 5,800,000.00 €.

Kryesuesi Burim Bujupi, pasi nuk pati diskutime, e hodhi në votim pikën e tetë, e cila u rekomandua për Kuvend. **Për votuan 4, abstenime 1, kundër 2.**

Kryesuesi Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e nëntë: **9. Të ndryshme.**

Egzona Tërdevci, kërkoj të silllet si pikë e rendit të ditës: Propozim-vendimi për emërimin e përfaqësuesve të Kuvendit Komunal në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Gjithashtu, kam një çështje për Kryetarin, të cilën e kam adresuar në seancën e kaluar lidhur me mbështetjen për fëmijët me sindromën Down.

Keni thënë se do të bisedoni me financat për t'i parë mundësitë, meqë 21 marsi është dita e tyre. Së fundi, një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike lidhur me dëmet nga vërshimet, një biznes në qendrën tregtare ka thënë se nuk ka mundur të aplikojë, sepse nuk ka pasur llogari biznesi në bankë, por llogari personale. A ka pasur hapësirë të merret parasysht kjo, pasi komisioni nuk e ka lejuar.

Drejtori Nexhmedin Gruda tha, për vlerësimin e dëmit është e detyrueshme të jetë llogaria e biznesit. E njohim si rast, por duhet patjetër të jetë llogaria e biznesit.

Kryesuesi Burim Bujupi tha se, të gjithë këta që kanë pasur dëme nga vërshimet dhe kanë kërkuar kompensim, a keni shkuar të secili prej tyre apo keni bërë ndonjë klasifikim.

Drejtori Nexhmedin Gruda, çdo kërkesë që ka ardhur nga qytetarët është trajtuar. Të gjithë qytetarët e kanë marrë përgjigjen, jo në mënyrë individuale, por mund të vijjnë dhe ta shohin në raport.

Kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim kërkesën e Egzonës për të shtuar pikën për emërimin e përfaqësuesve në Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe diskutimin e dëmeve. Pika rekomandohet për Kuvend. **Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.**

Kryesuesi Burim Bujupi, deklaroi se pasi nuk pati diskutime të tjera, mbledhja konsiderohet e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Gllogocit



Nr.01-020104-13264 dt. 14 / 09/2026

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 13,14 dhe 15 e Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IAAP) të arsimit parauniversitar, si dhe rekomandimit të DKA-së në Drenas, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2026, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim caktohen anëtarët e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, si vijon:

1. Arbesa Islami Dobra – Fakulteti Filozofik – Pedagogji e Përgjithshme (180 ECTS + Master – Pedagogji e Përgjithshme (120 ECTS) (DKA).
2. Lindihana Qorri – Fakulteti Filologjik – Lëtërsi Shqipe - 240 ECTS (Shkolla).
3. _____ - Anëtar (MASHTI).

Neni 2

Ky komision ka për detyrë që procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve t'i zhvilloj në përputhje me Rregulloren (QRK) nr:19/2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të komisionit nga DKA për Drejtor në Institucione Arsimore përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtare/e për përzgjedhjen e kandidatit/ëve në pozitën/at e kërkuara me konkurs.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Arsyetimi

Baza ligjore për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor, zëvendësdrejtorëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, është neni 14 i Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IAAP) të arsimit parauniversitar.

Neni 14 pika 8 pika 1,2 dhe 3, e Rregullores (QRK) nr:19/2024, thotë:

Komisioni përzgjedhës për institucionet arsimore obligohet të ketë përfaqësim gjinor që janë në varësi të komunës dhe ka këtë përbërje:

Dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Anëtari i parë është i punësuar në DKA, ndërsa anëtari i dytë i propozuar nga DKA mund të jetë: ekspert i pavarur i arsimit, drejtor/e i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e arsimit.

Anëtari i komisionit i punësuar në DKA, njëherit është edhe kryetar/e i/e komisionit;

Një anëtar/e nga MASHTI, i cili përcaktohet nga MASHTI, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA;

Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAA-AP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.

Prandaj në bazë të rregullores së lartëcekur kërkohet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, të aprovohet propozimi vendimi për anëtarët e komisionit përzgjedhës për Drejtor, zëvendësdrejtorëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.